



Pranuar / Dorezuar Puniheno/Prodato Received/Deliverty	23 - 06	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHUK	4899/2023		115	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.776/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.776/2023 të datës 25.05.2023, të parashtruar nga ankuesi të cilin më autorizim e përfaqëson Avokat

me adresë rruga kundër  
Vendimit me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.06.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.776/2023 e datës 25.05.2023 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 10/2023 i datës 25.04.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.**

### Arsyetim

Ankuesi që nga viti 2009 ka themeluar marrëdhënie punë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme në pozitën Asistent i Transportit/Vozitës, për të cilin ka poseduar fillimisht kontratë të marrëdhënies së punës pastaj Akt Emërim me Nr. 041 të datës 05.09.2012 dhe Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 12.09.2014.

Pas miratimit të Rregullores (ZKM) Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe pas procesit të ristrukturimit Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të

Brendshme më datë 10.05.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 79/2022 për transferimin e ankuesit në pozitën Asistent i Transportit-Vozitës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 18.04.2023 ka dërguar listën e zyrtarëve për deklaram të statusit të zyrtarit publikë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 ka bërë deklaramin/miratimin e statusit të zyrtarëve publikë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke konstatuar se nga numri rendor 1 deri 144 kanë statusin e nëpunësit civil ndërsa nga numri 145 deri në numrin 150 kanë statusin e nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ndërsa sipas listës së bashkëngjitur të këtij vendimi ankuesi është i renditur në numrin 148. Ankuesi lidhur me këtë vendim është njoftuar më datë 26.04.2023 nga Burimet Njerëzore MPJD.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 25.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4409/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të shkeljeve të drejtës materialeve, shkeljeve procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 31.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 31.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 4409/2023 të datës 25.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 19.10.2022; Emailin e datës 26.04.2023 nga Burimet Njerëzore MPJD për ankuesin; Vendimin me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe listën e zyrtarëve të MPJD-së; Kontratën e Marrëdhënies së punës e datës 05.02.2009; Akt Emërimin me Nr. 041 i datës 05.09.2012; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2021 i datës 27.10.2021; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 31.05.2023; Listën e zyrtarëve për deklaram të statusit e datës 18.04.2023 e dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të dërguar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i MPJD-së; Emailin e datës 30.05.2023 nga Burimet Njerëzore MPJD për ankuesin; Vendimin A.nr., 722/2022 të Këshillit; Vendimin me Nr. 79/2022 të datës 10.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. ZSP/134/2014 i datës 08.09.2014; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimin Nr. 41-2012 i datës 12.09.2014; Deklaratën nën betim e datës 19.06.2015 e ankuesit; Kontratë e Marrëdhënies së punës e datës 04.02.2011; Rekomandim për përtëritje të kontratës i datës 23.12.2010.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil kundër Vendimit me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se janë shkelë të drejtat materiale për shkak që i është ndërruar statusi nga nëpunës civil, në nëpunës administrativ dhe mbështetës në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që ky vendim është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe është i paligjshëm, duke kërkuar që ky vendim të anulohet dhe t' i kthehet statusi i shërbyesit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.722/2022 ka vendosur për statusin juridik të pozitës së ankuesit duke u shpall jo kompetent për të shqyrtuar ankesën e tij, mirëpo meqenëse tashmë me ankesën e datës 25.05.2023 kemi të bëjmë me kontestimin e aktit administrativ respektivisht Vendimit me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për deklarimin/miratimin e statusit të zyrtarëve publikë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ndër ta edhe ankuesit atëherë sipas procedurës ligjore, Këshilli do të shqyrtoj ankesën dhe ligjshmërinë e vendimit të kontestuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me Vendimin me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i është ndërruar statusi nga nëpunës civil, në nëpunës administrativ dhe mbështetës në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke kërkuar që ky vendim të anulohet dhe t' i kthehet statusi i shërbyesit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që kishte qenë në fuqi më herët konkretisht me nenin 4 ishin përcaktuar kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil, ku sipas paragrafit 4 të këtij neni ishte përcaktuar se: *"Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë"*, andaj me qëllim të zbatimit të këtij neni Ministria e Administratës Publikë në vitin 2014 respektivisht më datë 08.12.2014 ka nxjerr Qarkore Administrative me Nr. 6280 e cila në pikën 4 nën pikën 1 ka përcaktuar që pozitësit janë të përjashtuar nga shërbimi civil, mirëpo që Ministria e Punëve të Jashtme për pozitën e ankuesit ka mbajtur në fuqi Akt Emërimin/Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 12.09.2014.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 2 ka rregulluar marrëdhënien juridike të punës ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë, ndërsa ky nen ka përcaktuar se: *"2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës. 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e*



shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. 5. Nëpunës i Kabinetit - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar. 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se zyrtarët publik që kryejnë veprimtari të vozitjes nuk kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil por kanë statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, si rrjedhojë në kuptim të zbatimit të normave e të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka qenë obligim ligjor që të bëhet deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë si parashihet me nenin 83 paragrafi 16, ndërsa marr parasysh pozitën e ankuesit si Asistent i Transportit-Vozitës, Kolegji i Këshillit, konstaton se në këtë rast deklarimi i statusit për këtë kategori të të punësuarve ka qenë obligim pasi që pozita që mban ankuesi nuk është pozitë e nëpunësit të shërbimit civil dhe e njëjta duhet të përshtatet (rregullohet) me statusin e duhur të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji respektivisht statusin e nëpunësit të administrativo-teknik dhe mbështetës.

Përkitazi me ligshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr. 10/2023 të datës 25.04.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit, konstaton se sa i përket deklarimit të statusit të zyrtarit publik ndaj ankuesit ky vendim është i drejtë dhe në pajtim të plotë me dispozitat e cekura me lartë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, sepse deklarimi në rastin konkret të ankuesit është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, si rrjedhojë përcaktimi i statusit të pozitës së ankuesit është përcaktim ligjor dhe se në lidhje me statusin e ankuesit është vendosur edhe me Vendimin A.nr.722/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë që derivon nga marrëdhënia e punës e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase me deklarimin e statusit të pozitës së ankuesit vetëm është bërë konstatimi ligjor që ka qenë obligim për institucionet, andaj në rastin konkret të ankuesit nuk kemi shkelje të ligjit material, si rezultat i kësaj pretendimet e tij janë të pabazuara.

Nga ato që u thanë më lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.776/2023, datë 23/06/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së

